

Ekipe të suksesshme: Ndërtimi & puna në ekip

Konteksti dhe objektivat:

Nevoja për ekipe dhe punë ekipore nuk ka qenë kurrë më e madhe, duke pasur parasysh:

- Rritjen e pritshmërive të klientit (vlerë më e mirë për paratë e shpenzuara, më shumë mundësi zgjedhjeje dhe nevoja për të ofruar një paketë të plotë që mbulon cilësinë, shërbimin dhe mbështetjen në vazhdimësi)
- Kompleksitetin e tregjeve dhe produkteve
- Rritjen në pasigurinë tregtare (ndryshimi i tregjeve, ciklet më të shkurtra të jetës dhe nevoja për t'iu përgjigjur kërkesave të klientëve)
- Rritjen e presionit nga konkurrenca, legjislacioni dhe çështjet mjedisore

Tema kyçe që do trajtohen gjatë trajnimit:

- Cili është roli ynë në motivimin e stafit?
- Cilat janë elementet e motivimit?
- Si të influencojmë për rritje të motivimit?
- Çfarë është skuadra (ndryshimi mes skuadrës dhe grupit, ndryshimi mes ndërtimit të grupit dhe punës në grup);
- Si ndërtohet skuadra dhe ndërtimi i marrëdhënieve (synime të qarta skuadre dhe përgjegjshmëria personale janë thelbësore në procesin e ndërtimit të skuadrës);
- Rolet në skuadër (Modeli Belbin);
- Matja e rezultateve dhe vlerësimi i individëve;
- Zhvillimi i pjesëtarëve të skuadrës;
- Si t'a ndërtojme besimin dhe delegimin;

Metodologjia

Sesionet e trajnimit janë dizenuar të jenë interaktive. Eksperienca na ka treguar se pjesëmarrësit nxënë më shumë në aktivitetet në të cilat përfshihen aktivisht. Në një kohë të shkurtër ne njëkohësisht maksimizojmë impaktin e mësimit si edhe përfshijmë personalisht në aktivitete çdo pjesëmarrës të grupit.

Target Grupi

Specialistë sektori, mbikëqyrës/ supervizorë, drejtues skuadrash dhe/ose menaxherë

Kohëzgjatja: 2 ditë (09:00 - 17:00)

Tarifë pjesëmarrjeje: Për t'u përditësuar

Përfshirë në çmim: 2 pushime kafe + dreka